

03.03.2022

Ora 13:43

**RENDI I DITËS**

**Hedhja e shortit të Kërkesës Ankimore nr.4 me objekt “Ndryshimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 116, datë 02.03.2022”, subjekti ankues Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”.**

**PJESËMARRJA :**

- KAS:
- Stafi KQZ: Y. Merkaj, E. Mema

**Z. Y. Merkaj:** Përshëndetje të gjithëve! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur Kërkesa Ankimore nr. 4, datë 03.03.2022, ora 12:20, me ankues koalicionin “Shtëpia e Lirisë”. Objekt i ankimit “Ndryshimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr.116, datë 02.03.2022”. Objekti i vendimit “Shqyrtimi i kërkesës së Bashkisë Shkodër për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, për zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022”. Referuar nenit 14 të rregullores së KAS-it, do të hidhet shorti për caktimin e relatorit për Kërkesën Ankimore nr. 4. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, do të vazhdojmë me shortin duke caktuar një përfaqësues të KQZ-së, në emër për llogari të tyre të tërheqin goglat për caktimin e relatorit. Për këtë arsye kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në njërin kemi shkruar Kërkesën Ankimore nr. 4. Shiritat e letrës palosen dhe vendosen në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, të cilat hidhen në një enë transparente. Të pesta goglat, me shiritat e letrës, pasi i vëmë në një enë transparente, trazohen nga përfaqësuesi i

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.03.03.2022*

KQZ-së, dhe duke filluar sipas rendit alfabetik rritës, do të tërhiqen për emër dhe llogari të anëtarëve të KAS-it. Vazhdojmë me emrin e parë, i cili është Elvin Lako. Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - Kërkesa Ankimore nr. 4. Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilirjan Rusmali - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit, u caktua zoti Elvis Çefa, si relatori i Kërkesës Ankimore nr. 4. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



03.03.2022

Ora 17:32

**RENDI I DITËS**


*Për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 5 “Ndryshimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 116, datë 02.03.2022 “Shqyrtimi i kërkesës së Bashkisë Shkodër për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, për zgjedhjet e pjeshme vendore, të datës 6 Mars 2022”, me ankimues Bashkia Shkodër.”.*

**PJESËMARRJA :**

- KAS:
- Stafi KQZ: Y. Merkaj, E. Mema

*Z. Y. Merkaj:* Përshëndetje të gjithëve! Sot, në datën 03.03.2022 zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr.5. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur një kërkesë Ankimore nr. 5, ora 16:09, datë 03.03.2022, me ankues Bashkia Shkodër, me objekt ankimi “Kërkesë për shpalljen e pavlefshme të vendimit nr.116, datë 02.03.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”. Procedura e shortit është bazuar në nenin nr.14 të rregullores së KAS-it, ku duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, autorizohet një përfaqësues i KQZ-së të zhvillojë procedurën e shortit. Kështu janë përgatitur 5 shirita letre, ku në njëërën prej tyre është vendosur Kërkesa Ankimore nr. 5, katër shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime, të cilat futen në 5 gogla me ngjyrë, peshë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezentë, përfaqësuesi i KQZ-së do të tërheqë në emër dhe për llogari të tyre, për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.03.03.2022*

nr.5. Kështu, përfaqësuesi i KQZ-së, pasi përziën goglat në enën transparente, vazhdojmë me numrin alfabetik rritës, me zotin Elvin Lako.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako - Kërkesa Ankimore nr.5

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilirjan Rusmali - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit, relatori i Kërkesës Ankimore nr. 5, është zoti Elvin Lako. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

